# DËSHMI ARKIVI

**A-450584**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | E filmuan duke u marrë mijëra euro, noterja dhunon burrin dhe gruan shtatzënë - REPORT.AL |
| ADRESA | `https://report.al/e-filmuan-duke-u-marre-mijera-euro-noterja-dhunon-burrin-dhe-gruan-shtatzene/` |
| BURIMI | report.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 20:34:12 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 19:34:21 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `c23c942cc589c819c524e131453910715b1cf4d85cafca2c9d0121ff3b171e79` |
| TEKSTI | `46cb1e39db77760d4e0472c9eb323d570d5c73ad7b87bb8820f11ccf7e16e5fb` |
| PAMJA | `26d7db59f1a230b6bc4bf62d60d4e36f2b73fd1130a556d38edbb057d2cba64d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `237221eb82b2d79ea48b990cca87c03266aba8bd31e98770f8234e7dbf466e92` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `f72115bb0c326093347f412235a8c378aab409f85fb276171d0e9653b9a6bcbd` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/237221eb82b2d79ea48b990cca87c03266aba8bd31e98770f8234e7dbf466e92`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# E filmuan duke u marrë mijëra euro, noterja dhunon burrin dhe gruan shtatzënë

by **Bota Bota** — September 16, 2026 in **Aktualitet**, **Kronikë**

0 SHARES Share on Facebook Share on Twitter

Në emisionin "Stop" edhe këtë të mërkurë, më 16 shtator, vjen sërish një denoncim për noteren Anila Haxhiu në Fier.

Një çift pretendon, se i ka dhënë 3,200 euro për të mundësuar kalimin e pronësisë së një apartamenti në Golem, duke anashkaluar procedurën e rregullt ligjore dhe deklaratën e ish-bashkëshortes, e cila duhej të konfirmonte, se nuk kishte pretendime mbi pronën.

Sipas çiftit, një pjesë e shumës do t'u jepej punonjësve të Kadastrës Fier, ndërsa pjesa tjetër, do të mbahej nga noterja Anila Haxhiu. Çifti pretendon, se u kërkuan edhe 800 euro për procedurë të përshpejtuar, me premtimin, se prona do të kalonte në emër të blerësve brenda ditës.

"Stop" dokumenton momentin e dorëzimit të 3,200 eurove në zyrën e noteres. Por procedura zgjati rreth 3 muaj dhe nuk u realizua. Për këtë arsye, çifti kërkoi kthimin e parave. Përballja në zyrën e Haxhiut u tensionua.

Çifti i përmendi noteres, se momenti i dorëzimit të 3 200 eurove ishte regjistruar, e në këtë moment, Anila Haxhiu shtyu dhe goditi bashkëshortin, e më pas edhe gruan e tij shtatzënë. Çifti thotë, se më pas noterja i mbajti për disa momente mbyllur në zyrë.

Policia shoqëroi çiftin, për të bërë denoncimin, ndërsa noterja Anila Haxhiu nuk u shoqërua dhe qëndroi në zyrë. Pas incidentit, denoncuesit kontaktuan ish-bashkëshorten, e cila jeton jashtë Shqipërisë.

Ajo autorizoi nënën e saj përmes një prokure, që të jepte deklaratën, se nuk kishte pretendime mbi apartamentin në Golem. Pas kësaj, procedura u zgjidh në rrugë ligjore, sërish në zyrën e Haxhiut.

***Episodi 1:***

**Noterja Anila Haxhiu**– *Hej,o goce, mos më kërcëno mua…!*

**Denoncuesi**-*Jo, nuk të kërcënoj, zemra ime! Unë kam bërë kallzim, se këtu brënda zyrës tënde, me ke dhunuar. Kështuqë, do ta shikojmë edhe atë, të gjitha…*

**Noterja Anila Haxhiu**-*Mos më kërcëno mua ti! Hajde këtu ti!*

***Episodi 2.***

**Denoncuesi**– *1,100, 1500, 1900, 3200…*

**Noterja Anila Haxhiu**-*Nëmi motrës, t'i numëroi këtu dhe lavdi t'ia u bëjë Zotit! T'i numëroi pak!*

TË FUNDIT

21 viktima nga shembja e një ndërtese në Gaza, mes tyre tetë fëmijë
SEPTEMBER 16, 2026

E filmuan duke u marrë mijëra euro, noterja dhunon burrin dhe gruan shtatzënë
SEPTEMBER 16, 2026

Turqia dënon sulmin me dron ndaj Mekës në Arabinë Saudite
SEPTEMBER 16, 2026

Gjenerali i NATO-s: Jam i shokuar me vendimin e Hagës! Thaçi nuk është kriminel
SEPTEMBER 16, 2026

"UÇK, UÇK", protestuesit në Tiranë solidarizohen me ish-liderët e UÇK-së pas vendimit të Hagës (VIDEO)
SEPTEMBER 16, 2026

"Thaçi, Krasniqi, Veseli dhe Selimi në kapitujt më të ndritur të historisë sonë kombëtare", ish-presidenti Meidani: Në ç'emër flet kjo gjykatë kur populli proteston?
SEPTEMBER 16, 2026

Akt që na ka goditur të gjithëve", Majko përlotet pas vendimit për ish-liderët e UÇK
SEPTEMBER 16, 2026

Vendimi i Hagës për liderët e UÇK-së/ Protestuesit gjuajnë me gurë godinën qeveritare në Prishtinë, arrestohet një prej tyre. Tubim edhe para Parlamentit
SEPTEMBER 16, 2026

"Mburresh si 'trajner' i madh, por shokët i ke në qeli", protestuesit mesazhe të forta për Ramën
SEPTEMBER 16, 2026

Arrestohet Eno Agasi, kushëriri i Ergys Agasit
SEPTEMBER 16, 2026

**Noterja Anila Haxhiu**-*Nemi motrës, t'i numëroj këtu dhe lavdi t'ju a bëjë Zoti. T'i numëroj pak.*

**Denoncuesi**-*Jo numëroji, se tani s'i dihet!*

**Noterja Anila Haxhiu-**
*26,27,28,29,30,31,32,33,34,35,36,37,38,39,40,41,42,43,44,45,46,47,48,49.50.51.52.53.54.55.56.57,58,59,60 …Sa i bie 60-të?*

**Denoncuesi**-*60-të, i bie 3000 euro. 6×5 bëjnë 30!*

**Noterja Anila Haxhiu**-*Në rregull i ke shpirt.*

***Episodi 3.***

**Denoncuesi**-*Tani kjo, që do firmosi, ku do ta bashkangjiti?*

**Agjensia Imobiliare**-*Tek kontrata, që kemi!*

**Denoncuesi**-*Tek kjo, që kemi, ku do ta bashkangjisi?*

**Agjrnsia Imobiliare**-*Tek kjo, që kemi!*

**Denoncuesi**-*Ok! Hajde…!*

**Agjensia Imobiliare-***Dëgjo! Anila më tha, më mirë të rrish jashtë…!*

**Denoncuesi**-*Jo! S'bëhet fjalë!*

**Noterja Anila Haxhiu**-*Hajde pak hajde! S'ka kuptim kjo!*

**Denoncuesi**-*Si s'ka kuptim, kjo është shtëpia ime!*

**Noterja Anila Haxhiu**– *Rri, ulu jashtë!*

**Denoncuesi**-*Jo! Fare këtu!*

**Noterja Anila Haxhiu**-*O nëne, hajde pak..!*

**Denoncuesi**-*Jo, fare! N.q.s s'jam unë këtu, s'ka shans!*

**Noterja Anila Haxhiu**-*O motra! Ma jep mua këtu, se të ka autorizuar vajza për të firmosur dicka! Ma jep pak dokumentin! Të shoh cik tagrat, që na ka dhënë prokura. Ulu pak të lutem! Ulu pak!*

**Denoncuesi**-*Nuk ulem dot, se jam shtatzënë dhe nuk rri dot ulur!*

**Noterja Anila Haxhiu-***Nuk e di! Urime!*

**Denoncuesi**-*Do rri në këmbë, jam në këmbë, s'po të bezdis.*

**Noterja Anila Haxhiu**-*Mirë, dakord!*

**Denoncuesi**-*S'po bezdis fare njeri, as po të prek me dorë, as po flas, s'po bëj asgjë.*

**Noterja Anila Haxhiu**-*Po e paguaj unë taksën, oj goc,e paguaj unë taksën dhe nuk ke asnjë tagër këtu.*

**/Emisioni STOP**




Bota Bota



report.al

RUBRIKAT

Aktualitet

MË TË KLIKUARAT




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.